

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	S&P konfirmon vlerësimin e Shqipërisë në perspektivë të qëndrueshme ekonomike
ADRESA	https://www.cna.al/ekonomi/sp-konfirmon-vleresimin-e-shqiperise-ne-perspektive-te-qendrueshme-ekono-i474920
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:08:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 15:37:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	18bd8f8439c078af46a994fcfb232a0c140702d8dadeae60840f926b2a710560
TEKSTI	99858b137ed1365e932b9be5c9ff95bc1cfa294043395b4ad0cf3ba6bebf0b7
PAMJA	c33b6776c42f236497ff8a0661dcd6f3fa0953ff4c2f4c94769d337247c2624f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d27f16c01ae5ccd7658efee208834795e10c74b4f4357a3e275038dff5a0b431
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d27f16c01ae5ccd7658efee208834795e10c74b4f4357a3e275038dff5a0b431>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

S&P konfirmon vlerësimin e Shqipërisë në perspektivë të qëndrueshme ekonomike



22 Shtator 2026, 17:37, Ekonomi CNA



Agjencia e vlerësimit të kreditit "Standard & Poor's Global Ratings", në raportin e saj analitik të publikuar më 21 Shtator 2026, ka rikonfirmuar vlerësimin afatgjatë të kreditit sovran të Shqipërisë në "BB", duke ruajtur gjithashtu një perspektivë "të qëndrueshme". Agjencia thekson se ekonomia shqiptare ka shënuar një rritje të ndjeshme të të ardhurave për frymë gjatë viteve të fundit, ndërsa borxhi i qeverisë dhe borxhi i jashtëm në tërësi janë në trend rënës, sipas një njoftimi zyrtar nga Ministria e Financave.

Agjencia vlerëson se ekonomia shqiptare mbetet rezistente dhe se ka treguar qëndrueshmëri ndaj goditjeve të njëpasnjëshme në vitet e fundit, duke u rritur mesatarisht me 4% në vit në terma realë gjatë periudhës 2022–2025.

S&P parashikon një rritje të PBB-së reale prej 3.4% për vitin 2026, pak më ulët se 3.7% e vitit 2025 dhe mesatarisht 3% në vit për periudhën 2027–2029, e mbështetur nga eksportet e shërbimeve, konsumi privat dhe investimet. Pozicioni i jashtëm është forcuar gjatë viteve të fundit, kryesisht falë performancës së fortë të turizmit, ndërsa deficitet e llogarisë korente janë ngushtuar ndjeshëm gjatë periudhës 2023–2025.


Në aspektin e financave publike, S&P e konsideron pozicionin fiskal të Shqipërisë si të fortë krahasimisht me tregjet në zhvillim dhe me një kornizë të kujdeshme fiskale. Agjencia parashikon një deficit buxhetor prej 2% të PBB-së në vitin 2026, nën limitin prej 2.3% të autoriteteve shqiptare dhe deficit mesatarisht rreth 2% të PBB-së, deri në vitin 2029. S&P i konsideron të arritshme objektivat e rregullave fiskale të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit dhe vëren se Shqipëria ka regjistruar suficit primar që nga viti 2023. Borxhi publik parashikohet të zbrisë në 50.5% të PBB-së në fund të vitit 2029, nga 52.9% në vitin 2025.

Një zhvillim pozitiv i theksuar nga S&P është procesi i anëtarësimit në BE, ku agjencia vëren progresin në reformën në drejtësi dhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe hapjen e të gjashtë grupkapitujve negociues, që shënon një gur kilometrik të rëndësishëm në bisedimet e anëtarësimit.

Rezervat valutore të Shqipërisë janë rritur në 8.1 miliardë euro (27% e PBB-së) në fund të korrikut 2026, të mbështetura nga prurjet e forta eksporteve të shërbimeve, kryesisht turizmit, si dhe të flukseve hyrëse të Investimeve të Huaja Direkte, të cilat i kanë mbuluar deficitet e llogarisë korente.

Sektori bankar mbetet likuid, i mirëkapitalizuar dhe me përfutueshmëri të qëndrueshme. Kreditë e këqija ishin 4% në fund të korrikut 2026, ndjeshëm nën nivelin prej 11% para pandemisë.

Vlerësimi i S&P është një tregues i qartë i progresit të vazhdueshëm të Shqipërisë dhe një sinjal pozitiv për investitorët ndërkombëtarë, duke reflektuar qëndrueshmërinë e ekonomisë, politikën e matur fiskale dhe forcimin e pozicionit të jashtëm të vendit./Monitor



Të sugjeruara

Skemë e re për ndërtimet/ 30% për strehim social, 40% strehim të përballueshëm për shtresë mesme

Euro vijon “rrokullisjen”, prek rekord të ri në vlerën e 91.4 lekëve

Taksat e karburantit në Europë/ Cili vend takson më shumë benzinën?

Hetimet dhe sekuestrimet e SPAK-ut ulin kërkesën për apartamente, kush po blinte?!

Punësimi sezonal jashtë solli një rekord të ri historik prej gati 400 milionë eurosh në janar-qershor

Monedhat e huaja thellojnë rënien/ Kursi i këmbimit, 22 shtator 2026

Të ardhurat buxhetore rriten me 11.7% në 8-mujor, një e treta e shtesës nga ndërtimet e reja

Bizneset shqiptare përshpejtojnë digjitalizimin, rritet përdorimi i AI dhe shitjeve online

Si e arriti dhe e kaloi Shqipëria mesataren e BE-së me çmimet e ushqimeve

Kursi i këmbimit, 21 shtator 2026

Moody’s paralajmëron Shqipërinë për goditjen që mund të vijë nga tregu i pasurive të paluajtshme

Situata e tregut imobiliar në Shqipëri/ Pse banesa po bëhet luks?

Ndryshime për monedhat e huaja/ Kursi i këmbimit, 20 shtator

Vera 2026 rriti numrin e turistëve, por shtoi pikëpyetjet

Moody’s përmirëson perspektivën për Shqipërinë/ Konfirmon vlerësimin “Ba3”

Bordi i Transparencës vendos çmimet e reja/ Ja sa do të tregtohen nafta dhe benzina

Monedhat e huaja thellojnë rënien/ Kursi i këmbimit, 19 shtator 2026

Formalizimi i punës mbetet i kushtueshëm në Ballkanin Perëndimor

Kursi i këmbimit valutor, 18 shtator 2026


“Taksë e fshehtë” mbi naftën për rezervën e sigurisë/ Do të rritet çmimi, e pranon edhe qeveria

[editorial](#)

16:30 Editorial

Agasi, Veliaj, Proda, Hyseni: Harta e një shteti që po shpërbëhet

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

22:05 Opinione Luan Rama

Kur kryeministri është edhe president dhe presidenti ndihmës i kryeministrit

21:14 Opinione Filip Çakulli

Tani i Madh, Topi i Madh

10:01 Opinione Ardi Stefa

Patriotët selektivë të patriotizmit selektiv

[Lifestyle](#)

14:00 Lifestyle

Ishte shtruar në klinikë rehabilitimi/ Ndërron jetë djali i modeles së njohur

Presley Gerber, djali i supermodeles Cindy Crawford, ka nd...

00:00 Lifestyle

05:00 Lifestyle

Jeshilja e ullirit/ Si ta kombinoni ngjyrën elegante që po "pushton" vitin

Jeshilja e ullirit po rikthehet fuqishëm dhe premtan të bë...

07:38 Lifestyle

Nga Europa në SHBA/ Ja cilat janë qytetet më të mira të botës

Qytetet evropiane dhe të Amerikës së Veriut dominojnë Inde...

20:40 Lifestyle

Si të shmangni shpërthimin e pijeve të gazuara? Ja një truk i thjeshtë

Kushdo që ka hapur një kanaçe pijeje të gazuar pasi ajo ës...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.